



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**



Nr. 1155 Prot

Tiranë, më 04.08.2016

Nr. 774 Dosje

**VENDIM**

PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Altin Vako, me detyrën e Përmbauesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1709 (31000-07568-80-2015) Regj.Them, të lëshuar në datë 04.12.2015 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdher, duke regjistruar në dosjen përmbareshmë, Nr. 774, datë 14.07.2016, kërkesën e kreditorit, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T (ish – I.N.U.K), ndaj debitorit Shoqërisë “XHENIS - SH” Sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv – Vendim për Dënimin me Gjobë Nr. 13, datë 27.10.2014.

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 997 Prot, datë 18.07.2016 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e Shoqërisë “XHENIS - SH” Sh.p.k, si dhe Znj. Margerita Mlloja (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë “XHENIS - SH” Sh.p.k).

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar pranë:

- DRSHTRR Shkodër me shkresën Nr. 1112 Prot, datë 01.08.2016
- Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me shkresën Nr. 1111 Prot, datë 01.08.2016
- Bankave Nivelit II me shkresën Nr. 1113 Prot, datë 01.08.2016

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

**KONSTATOJ**

Se pas nxjerrjes së llogarisë pranë “Banka Kombëtare Tregtare” Sh.a, informohem se nga ana e Shoqërisë “XHENIS - SH” Sh.p.k, e gjithë shuma e detyrimit ishte derdhur në llogarinë e Përmbauesit Gjyqësor Altin Vako, duke zbatuar plotësisht vendimin e gjykatës.



Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedures Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

### VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1709 (31000-07568-80-2015) Regj.Them, datë 04.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. DRSHTRR Shkodër, të bëjë ç’bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Shoqëria “XHENIS - SH” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: J97113009L dhe Znj. Margerita Mlloja, (atësia: Muhamet, datëlindja: 13.05.1955), të cilat janë bllokuar me anë të shkresës Nr. 1112 Prot, datë 01.08.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit II të bëjnë ç’bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të Shoqërisë “XHENIS - SH” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: J97113009L dhe Znj. Margerita Mlloja, (atësia: Muhamet, datëlindja: 13.05.1955), të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1113 Prot, datë 01.08.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Regjistrimit të beje ç’bllokimin e aksioneve apo kredive të Shoqërisë “XHENIS - SH” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: J97113009L dhe Znj. Margerita Mlloja, (atësia: Muhamet, datëlindja: 13.05.1955), të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1111 Prot, datë 01.08.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh.

### PËRMBARUES GJYQËSOR

**ALTIN VAKO**

